

VENDIM
Nr. 16, datë 17.2.2012

MBI KAPACITETET E INTERKONJEKSIONEVE NË DREJTIMIN IMPORT-EKSPORT PËR
MUAJIN MARS 2012

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuar nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe KESH sh.a. me nr. 807, prot., dhe nr. 642, prot., datë 10.2.2012 në lidhje me alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve në drejtimin import për një periudhë 3-4 mujore, u njoh me opinionin e OST sh.a. mbi këtë kërkesë, dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstaton:

- Mungesën e theksuar të reshjeve gjatë gjithë vitit 2011 dhe për periudhën në vijim, e cila reflekton një situatë të vështirë hidroenergjetike, me nivele shumë të ulëta të rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, si dhe basenet e tjera të hec-eve që operojnë në vendin tonë. Më datë 14.2.2012 kuota në basenin e hec-it Fierzë rezultoi 259 metra.

- Moti me temperatura të ulëta është shoqëruar me një rritje të ndjeshme të kërkesës për energji elektrike dhe si të tillë, e nevojës për të importuar energji elektrike në pamundësi të plotësimit të kërkesës për energji të klientëve tariforë nga prodhimi vendas. Nga administrimi i të dhënave të marra në evidencën e dërguar nga OST, rezultoi se konsumi për energji elektrike ka shënuar vlerën rreth 25 milionë KWh dhe si të tillë është rritur kërkesa për mbulimin e këtij konsumi nëpërmjet importit të energjisë elektrike nga vendet fqinje i cili aktualisht rezultoi në vlerën rreth 10 milionë KWh.

- Rritja e kërkesës për energji elektrike dhe si të tillë e sasisë së energjisë elektrike për t’u importuar nga dy kompanitë bën që KESH sh.a. dhe “Cez shpërndarje” sh.a. të kenë nevojë për kapacitete të sigurta dhe të plota të kapaciteteve të interkonjeksionit në të gjitha linjat përkatëse të Shqipërisë me vendet fqinje për të siguruar furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve në vend.

- Më datë 12.2.2012 Këshilli i Ministrave vendosi shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit, në njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin e Librazhdit.

Për gjithë sa më sipër, me qëllim moscenimin e furnizimit pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve të energjisë elektrike (tarifore dhe te kualifikuar), Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Për muajin mars 2012, OST do të alokojë proporcionalisht kapacitetet e interkonjeksionit në drejtimin import-eksport, për mbulimin e kërkesës për energji elektrike nga klientët tariforë, përfshirë humbjet në sistemin e shpërndarjes, në masën 365 MW, dhe për mbulimin e kërkesës për energji elektrike nga klientët e kualifikuar në masën 40 MW, në përputhje me nominimet fizike të paraqitura në OST nga pjesëmarrësit e tregut sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani